



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA EKONOMIKE, FINANCËS DHE BUXHETIT

PROJEKT-VENDIM

Nr Datë .03.2026

**PËR**  
**MIRATIMIN E TAVANEVE BUXHETORE TË PROGRAMIT BUXHETOR**  
**AFATMESËM VENDOR 2027-2029 TË BASHKISË KOLONJË**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për qeverisjen vendore” neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak “ gërma dh, ligji nr 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore” ligji nr 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” shkresën e Ministrisë së Financave , nr. prot 3736, datë 27.02.2026 “Dërgohet Udhëzimi për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027-2029”, “ Udhëzimi nr 7 , datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029 ,VKB nr.145, datë 22.12.2025 “ Për miratimin e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2026,VKB nr. 5, datë 27.01.2026 “ Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2027-2029, me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë,

**I propozoj Këshillit të Bashkisë Kolonjë në mbledhjen e tij të datës 17 .03.2026**

1. Të miratojë të ardhurat totale të Bashkisë Kolonjë sipas burimeve

000/lekë				
Nr	Burimet e financimit	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
1	Transferta e Pakushtëzuar	221.828	229.768	237.362
2	Transferta sektoriale për funksionet e transferuara	170.275	170.275	171.980
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore	100.187	100.187	100.187
	<b>TOTALI I BURIMEVE</b>	<b>492,290</b>	<b>500,230</b>	<b>509.529</b>

**Tabela përmbledhëse e shpenzimeve totale të bashkisë sipas programeve buxhetore dhe raportit mbi të ardhurat totale**

000/lekë

Art	Emërtimi i shpenzimit	Viti 2027	Diferenca në %	Viti 2028	Diferenca në %	Viti 2029	Diferenca në %
600+601	Paga +sigurime shoqërore	316.648	64.32	316.648	63.30	325,869	63.95
602+609	Shpenzime Korrente	107.592	21.86	110.632	22.12	110.710	21.73
231	Shpenzime për investime	68.050	13.82	72.950	14.58	72.950	14.32
	<b>Shuma</b>	<b>492.290</b>	<b>100</b>	<b>500.230</b>	<b>100</b>	<b>509.529</b>	<b>100</b>

1. Bashkalidhur tavanet buxhetore sipas programeve buxhetore për vitet 2027-2029.


  
**KRYETARI**  
**ERION ISAI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KOLONJË**  
**DREJTORIA EKONOMIKE, FINANCËS DHE BUXHETIT**

Nr 1770prot

Ersekë më 12/03/2026

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKT-VENDIM**

Nr     Datë     .03.2026

**PËR HARTIMIN E TAVANEVE BUXHETORE TË PBA 2027-2029**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për qeverisjen vendore” neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak “ gërma dh, ligji nr 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore” ligji nr 68/2017 ‘ Për Financat e Vetqeverisjes Vendore” shkresën e Ministrisë së Financave, 3736, datë 27.02.2026 “Dërgohet Udhëzimi për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027-2029”, “Udhëzimi nr 7 , datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029 ,VKB nr.145, datë 22.12.2025 “ Për miratimin e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2026,VKB nr. 5, datë 27.01.2026 “ Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2027-2029, administrata nën kujdesin dhe monitorimin e Kryetarit të Bashkisë punoi për hartimin e tavaneve buxhetore për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 duke u mbështetur në parashikimet e buxhetit vjetor 2026, PBA 2026-2028, planin e përgjithshëm vendor, diskutimit në takimin e GMS-së.

Tavanet buxhetore u përgatitën për çdo funksion dhe nënfunksion buxhetor të miratuar nga qeverisja qendrore dhe për çdo artikull, paga dhe sigurime shoqërore (600+601) , shpenzime korrente (602) shpenzime për investime (230+231).

**I.Totali i të ardhurave sipas burimeve paraqitet si më poshtë:**


**Të ardhurat totale të bashkisë Kolonjë sipas burimeve**

000/lekë				
Nr	Burimet e financimit	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
1	Transferta e Pakushtëzuar	221.828	229.768	237.362
2	Transferta sektoriale për funksionet e transferuara	170.275	170.275	171.980
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	100.187	100.187	100.187
	<b>TOTALI I BURIMEVE</b>	<b>492,290</b>	<b>500,230</b>	<b>509.529</b>

### **Analiza e burimeve financiare**

- a. Po të bëjmë krahasimin e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2027 krahasuar me vitin 2026 kemi shtesë prej 7.036 mijë lekë ose 3.28 %. Viti 2028 krahasuar me vitin 2027 është rritur në vlerën 7.940 mijë lekë ose 3.58%. Viti 2029 krahasuar me vitin 2028 ka rritje në vlerën 7.594 mijë lekë , ose 3.31 % .Shifrat sipas shkresës së ministrisë së Financave , nr.prot 3736,datë 27.02.2026 “Dërgohet Udhëzimi për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”, “ Udhëzimi nr 7, datë 27.02.2026 së bashku me shtojcat .
- b. Po të bëjmë krahasimin e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2027-2028, ka një rritje përkatësisht me 2%,ndersa per vitin 2029 ka nje rritje prej 1%.
- c. Të ardhurat e veta të bashkisë janë të miratuara me VKB nr 5, datë 27.01.2026 “ Për miratimin e Raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave , i njëjtë për të tre vitet buxhetore në shumën 100.187 mijë lekë .

**Paraqitja grafike e totalit të burimeve:**



**II. Tabela përmbledhëse e shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë paraqitet si më poshtë:**


**Tabela përmbledhëse e shpenzimeve totale të bashkisë sipas programeve buxhetore dhe raportit mbi të ardhurat totale**

000/lekë

Art	Emërtimi i shpenzimit	Viti 2027	Diferenca në %	Viti 2028	Diferenca në %	Viti 2029	Diferenca në %

600+601	Paga +sigurime shoqërore	316.648	64.32	316.648	63.30	325,869	63.95
602+609	Shpenzime Korrente	107.592	21.86	110.632	22.12	110.710	21.73
231	Shpenzime për investime	68.050	13.82	72.950	14.58	72.950	14.32
	<b>Shuma</b>	<b>492.290</b>	<b>100</b>	<b>500.230</b>	<b>100</b>	<b>509.529</b>	<b>100</b>

### Paraqitja grafike e shpenzimeve totale



➤ **Analiza për shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore.**

a. Po të bëjmë krahasime të shifrave rezulton se fondi i pagave është i njëjtë në dy vitet e para. Ky fond zë rreth 64.32 % në vitin 2027 kundrejt shpenzimeve totale , 63.30% në vitin 2028 dhe 63.95 % në vitin 2029.

➤ **Analiza për shpenzimet operative 602-609 .**

a. Po të bëhet krahasimi i shifrave për shpenzimet korrente nga një vit tek tjetri kemi trend rritës në masën 2.86 % në vitin 2028 krahasuar me vitin 2027, dhe 0.07 % rritje në vitin 2029 krahasuar me vitin 2028.

b. Po të krahasojmë vitin 2028 me vitin 2027 kemi një shtesë në vlerën 3.040 mijë lekë, në vitin 2029 kemi shtesë 78 mijë lekë në krahasim me vitin 2028.

➤ **Analiza për shpenzimet për projekte dhe investime**

- a. Po të bëhet krahasimi i shifrave për shpenzimet për investime nga një vit në tjetrin kemi trend rritës në dy vitet e pare në masën 7.20 % në vitin 2028 krahasuar me vitin 2027, ndersa kemi te njejtin nivel te shpenzimeve per investime ne vitin 2029 krahasuar me vitin 2028,pasi shtesa per kete vit ka kaluar per indeksimin e pages.
- b. Krahasuar me vitin 2027 ku janë planifikuar shpenzimet për investime në masën 68.050 mijë lekë në vitin 2028 jane planifikuar në vlerën 72.950 mijë lekë, në vitin 2028 me rritje në vlerën 4.900 mijë lekë më shumë se viti 2027,ndersa ne te njejtin nivel me 2028 jane investimet ne vitin 2029.

Dhe të gjitha ndryshimet me trend rritës do të përkthehen në garantimin e shërbimeve ndaj qytetarëve , rritjen e investimeve për komunitetin ,realizimin dhe përmbushjen e misionit , qëllimeve dhe objektivave të të PBA-së 2027-2029.

**Konc: Drejtori D.F.E.B G.Duka**

